



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
KRYETARI

Nr. 4107 Prot.

Fier më 03 04 /2025

VENDIM
NR. 10 dt. 03 /04 /2025

“Për përcaktimin e vendeve publike në territorin e Bashkisë Fier për afishimin prej partive politike dhe subjekteve zgjedhore, të materialeve propagandistike, për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë , të datës 11-Maj 2025”

Në mbështetje të nenit 2 pika” 1” , nenit 3 pika” 5”, nenit 77 pika” 1” , nenit 78 pika “1” dhe “4”, nenit 79 si dhe nenit 88 të Ligjit nr.10019, date 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar , në mbështetje të Ligjit nr.8580, date 17.02.2000 “Për partitë Politike” , i ndryshuar si dhe në zbatim të Vendimeve të KQZ-së ,Udhëzimet e KSHZ-së dhe Komisionit Rregullator , Udhëzimit nr.6, date 23.03.2021 të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ) “Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet per afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”, në kuadër të zhvillimit të një fushate elektorale të rregullt e korrekte , në kuadër të respektimit dhe mbajtjes pastër të hapësirave publike të Bashkisë, në cilësinë e Kryetarit te Bashkisë Fier,

VENDOSA:

1. Të caktoj vendet publike, në territorin e Bashkisë Fier për afishimin prej partive politike dhe subjekteve zgjedhore të materialeve propagandistike, për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë , të datës 11 Maj 2025, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.;
2. Subjektet zgjedhore lejohen te ngrenë jo me shumë se 1 (një) zyrë zgjedhore (elektorale) për lagje qyteti ose fshati.Subjektet zgjedhore janë të detyruara të njoftojnë me shkrim Kryetarin e Bashkisë Fier, për adresat e sakta të zyrave elektorale në territorin e Bashkisë Fier, jo më vonë se 35 ditë para dates së zgjedhjeve;
3. Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, përdorimi dhe afishimi I materialeve propagandistike zgjedhore statike, përfshirë flamuj dhe postera, lejohet vetëm në një distancë (në një largësi) prej jo më shumë se 5 (pesë) metra nga zyra zgjedhore (elektorale) e partisë politike apo subjektit zgjedhor përkatës dhe jo më parë se 30 (tridhjetë) ditë para datës së zgjedhjeve;

4. Të gjitha materialet propagandistike visive që përdoren në fushatë duhet të shoqërohen me shënimin: “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të”(vijon emri i subjektit zgjedhor);5.
5. Ndalohet përdorimi dhe afishimi I materialeve propagandistike që mund të ndodhen në qendrën e votimit dhe rreth saj në një rreze prej 300 m;
6. Ndalohet përdorimin I materialeve propaganduese me natyrë ndotëse (*përdorimi I bojërave të ndryshme ose spray paint për shkrimin e parullave elektorale në mure apo në vende publike, vendosja në shtylla, etj.*) si dhe përdorimi I materialeve propaganduese në kundërshtim me përcaktimet e bëra në këtë vendim, që përbejnë dëmtimim apo cënim të hapësirave apo investimeve publike, të cilat do të rikuperohen në gjendjen fillestare me kosto të vetë partisë politike apo subjektit zgjedhor përkatës;
7. Ndalohet në perimetrin prej 150 metrash rreth qendrës së votimit intimidimi si dhe sjelljet agresive , frikësuese , shantazhuese dhe kërcënuese të çdo lloj forme , çdo veprim që pengon apo ndërhyt në hyrjen , daljen ose aksesin e zgjedhësve në ambientet e votimit , si dhe vendosja e materialeve që synojnë të ndikojnë tek votuesit
8. Bashkia, nëpërmjet organeve të zbatimit të ligjit në varësi të saj do të heq menjëherë të gjitha materialet propagandistike të subjekteve zgjedhore, që janë afishuar në vende jashtë përcaktimeve të këtij vendimi dhe që janë në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe Vendimet e KQZ-së si dhe udhëzimet e KSHZ-së dhe Komisionit Rregullator;
9. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Ndjekjes së Kundravajtjeve Administrative dhe Policia Bashkiake , Inspektoriati Vendor I Mbrojtjes së Territorit (IVMT) ,Bashkia Fier , Drejtoria e Programimit , Kontrollit të Investimeve dhe Punëve Publike , Ndërmarrja e Shërbimeve Publike , Bashkia Fier ;
10. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

KRYETAR

Armando Subashi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
KRYETARI

Nr. 4106 Prot.

Fier më 03 / 04 / 2025

VENDIM
NR. 09 dt. 03 / 04 / 2025

**“PËR AFISHIMIN E MATERIALEVE EDUKATIVE ZGJEDHORE PËR ZGJEDHJET PËR
KUVENDIN E SHQIPËRISË , TË DATËS 11-MAJ 2025”**

Në mbështetje të dispozitave ligjore të Ligjit nr.10019, date 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor I Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar , si dhe Udhëzimeve të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor”, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Fier,

VENDOSA:

1. Të caktoj vendet publike, me akses dhe hapësirë të bollshme për publikun për afishimin e materialeve edukative zgjedhore, në dispozicion të KQZ-së ose palëve të treta që nuk promovojnë fushatën e një subjekti të caktuar zgjedhor politik, materiale edukative zgjedhore të cilat i shërbejnë edukimit të zgjedhësve, lidhur me të drejtat e tyre dhe procedurat e regjistrimit dhe të votimit sipas Kodit Zgjedhor, për fushatën zgjedhore për Zgjedhjet për Kuvend , të datës 11 Maj 2025, sipas listës bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Ndjekjes së Kundravajtjeve Administrative dhe Policia Bashkiake , Inspektoriat i Mbrojtjes së Territorit (IVMT) , Bashkia Fier , Drejtoria e Programimit , Kontrollit të Investimeve dhe Punëve Publike , Ndërmarrja e Shërbimeve Publike , Bashkia Fier, si dhe të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë Fier;
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

KRYETAR

Armando Subashi

**LISTA E AMBJENTEVE PUBLIKE ME AKSES TË PLOTË DHE HAPËSIRË TË BOLLSHME
PËR PUBLIKUN
PËR AFISHIMIN E MATERIALEVE EDUKATIVE ZGJEDHORE PËR ZGJEDHJET
PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË , TË DATËS 11-MAJ 2025**

- Zyra e Marrëdhënieve me Publikun (Zyra me një ndalesë) , Bashkia Fier ;
- Këndet e njoftimeve pranë Zyrave të Gjendjes Civile pranë Njësive Administrative Nr.1;Nr.2;Nr.3;Nr.4, Bashkia Fier ;
- Këndet e njoftimeve në ambientet e Njësive Administrative , Bashkia Fier:
 - Njësia Administrative Qëndër;
 - Njësia Administrative Mbrostar- Ura;
 - Njësia Administrative Portëz;
 - Njësia Administrative Cakran;
 - Njësia Administrative Libofshë;
 - Njësia Administrative Levan;
 - Njësia Administrative Frakull;
 - Njësia Administrative Topojë;
 - Njësia Administrative Dërmënas.